



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:186688  
Datë: 16.02.2024  
Numri i dokumentit: 05340743

**Ac.nr.279/2021**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naime Ahmeti, kryetare e kolegjit, Halide Reka dhe Adnan Konushevci, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit L.A., nga fshati D....., Komuna e Gjilanit, pronar i NSH “T..... P...-I...”, me seli në Gjilan, të cilin e përfaqëson I.Q., jurist nga Prishtina, kundër të paditurës K.S., “K..... e R.....” me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson V.R., avokat nga Prishtina, me objekt kontesti kompensim i dëmit, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësuesit të paditësit, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.765/2019 të datës 09.07.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 06.02.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e përfaqësuesit të paditësit L.A., nga fshati D....., Komuna e Gjilanit, pronar i NSH “T.... P....-I...”, me seli në Gjilan, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.765/2019 të datës 09.07.2020, **VERTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.765/2019 të datës 09.07.2020, në pikën një të dispozitivit ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit L.A., nga fshati D....., Komuna e Gjilanit, pronar i NSH “T..... P...-I...”, me seli në Gjilan, ndaj të paditurës K.S., “K..... e R...” me seli në Prishtinë, me të cilën paditësi ka kërkuar që në emër të mos përmbushjes së kontratës t’i kompensohet dëmi material në shumë prej 1,961.00 euro dhe në emër të fitimit të humbur shumën prej 5,400.00 euro, në shumën e përgjithshme prej 7,361.00, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive. Në pikën dy, secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur përfaqësuesi i paditësit, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit, ta aprovoj ankesën e paditësit, të anuloj aktgjykimin C.nr.765/19 të datës 09.07.2020, dhe lëndën të kthej në rigjykim apo ta ndryshoj aktgjykimi duke aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si dhe të obligoj të paditurën në kompensimin e të gjitha shpenzimeve të procedurës dhe shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në ankesë në shumë prej 310 euro.

Përgjigje në ankesë ka ushtruar përfaqësuesi i të paditurit duke i kundërshtuar pretendimet ankimore, me propozim që gjykata ankimore të refuzoj si të pabazuar ankesën e paditësit dhe të vërtetoj aktgjykimin e shkallës së parë C.nr.765/19 të datës 09.07.2020, si dhe të detyroj paditësin në t'i paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 582.00 euro.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së neneve 194 dhe 195.1, pika (d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, ka gjetur se:

#### **-Ankesa është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, me padinë e parashtruar në gjykatën e shkallës së parë, ka kërkuar që të detyrohet e paditura për kompensimin e dëmit, në shumën prej 7,361.00 euro. Duke vepruar sipas padisë, gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar procedurën gjyqësore dhe ka vendosur për refuzimin e kërkesëpadisë, pas administrimit dhe shqyrtimit të provave: raporti i aksidentit nr.XXX-CR-XX i datës 24.12.2018, polica e sigurimit nr.XXX e datës 12.09.2018, procesverbali mbi dëmtimin e automjetit i datës 08.01.2019, njoftimi nr.X/X i datës 10.01.2019 dhe ekspertiza e datës 04.03.2020. Gjykata e shkallës së parë, pas vërtetimit të mos ekzistimit të bazës së kërkesëpadisë ka vendosur lidhur me refuzimin e të njëjtës duke u bazuar në dispozitat e nenit 938, 923 të LMD-së, ndërsa lidhur me shpenzimet e procedurës ka vendosur konform dispozitës së nenit 450 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 181 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as me shkelje të tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, aktgjykimit të atakuar, si dhe shkresave të lëndës, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes rreth kërkesëpadisë së paditësit, drejtë dhe në mënyrë të plotë ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore, ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, e si rezultat i kësaj,

drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale, për të cilat arsye, aktgjykimi i atakuar është dashur të vërtetohet në tërësi.

Kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, pasi që sipas policës së sigurimit K...., afati për lajmërimin e dëmit nga ana e të siguruarit është *24 orë nga momenti i ndodhjes së aksidentit* siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 19, paragrafi 1 dhe 2 të policës Kasko. Po ashtu, duke u bazuar në dispozitën e nenit 938, paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kontraktuesi i sigurimit ka për detyrë, përveç në rastin e sigurimit të jetës ta njoftojë siguruesin për paraqitjen e rastit të sigurimit jo më vonë se tri (3) ditë që kur ai vihet në dijeni për këtë”*, ndërsa sipas nenit 923, paragrafi 1 të LMD-së përcaktohet se: *“Në policë duhet të shkruhen palët kontraktuese, sendi i siguruar, respektivisht personi i siguruar, rreziku i përfshirë nga sigurimi, kohëzgjatja e sigurimit dhe periudha e depozitës, shuma e sigurimit ose se sigurimi është i pakufizuar, premia ose kontributi, data e dhënies së policës dhe nënshkrimet e palëve kontraktuese.”*. Në rastin konkret, aksidenti ka ndodhur me datën 24.12.2018, ndërsa lajmërimi i aksidentit nga ana e paditësit tek e paditura është bërë me datën 08.01.2019, që nënkupton pas afatit të paraparë ligjor.

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes, shqyrtoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore të palës paditëse, por të njëjtat nuk patën ndikim relevant në vendosjen ndryshe në këtë çështje juridike.

Tutje, Gjykata ankimore vlerësoj edhe pretendimin e paraqitur në përgjigje në ankesë nga ana e të paditurës, sa i përket kompensimit të shpenzimeve të procedurës të njëjtës sipas suksesit në procedurë, mirëpo vlerësoj se në rastin konkret nga ana e të paditurës nuk është paraqitur ankesë lidhur me shpenzimet e procedurës dhe se pretendimet e paraqitura në përgjigje në ankesë nuk mund aprovohen në atë mënyrë që të ndryshohet aktgjykimi i atakuar.

Nga të gjitha arsyet e cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi të shkallës së dytë, Gjykatës së Apelit i rezulton se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga nenet 194, 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.279/2021, me datë 06.02.2024**

**Kryetarja e kolegjit**  
**Naime Ahmeti d.v,**